**L=560 m** me **b=6.0 m**, me trotuare në të dy anët e rrugës, të cilët shkojnë deri në **2.0 m**. Rruga është me shtresë kaluese nga asfalti, në një pjesë prej  $15 \text{ m}^2$  rruga është e dëmtuar, andaj duhet të bëhet demolimi i asfaltit. Në pikat ku kemi deformime të asfaltit duhet të bëhet gërmimi i dheut të kategorisë: III, IV dhe V, me makinë dhe dorë, në raport (70 me 30%) pas heqjes së asfaltit në pikat ku kemi dëmtim të bazës së asfaltit, në thellësi -55cm, si dhe kompaktimi pas rrafshimit me modul të ngjeshjes  $M_v > 30 \text{ Mn/m}^3$ . Duhet të parashihet edhe largimi i dheut dhe asfaltit deri në deponi, si dhe vendosja dhe ngjeshja e tamponit  $M_v > 90 \text{ MN/m}^2$  prej gurit të thyer gëlqeror, me fraksion: 0-63mm, me trashësi  $t = 40 \text{ cm}$ , si bazë për vendosjen e trupit të rrugës në pikat ku kemi dëmtime të konstruksionit të rrugës, si dhe punimi i shtresës së binderagregatit: 0-31CS, me trashësi  $t = 10,0 \text{ cm}$ , si dhe spërkatja me emulzion në hapësirat ku kemi larguar asfaltin për përforsim të bazës. Duhet të bëhet gërryerja e shtresës finale ekzistuese të asfaltit në tërë hapësirën e rrugës dhe vendosja e një shtresës përfundimtare nga asfalt betonit AB16S, me trashësi  $t = 5,0 \text{ cm}$ , duke përfshirë pastrimin, larjen dhe spërkatjen me emulsion në tërë hapësirën e rrugës para shtrimit të asfalt betonit.


Trotuaret në disa vende janë nga betoni, në disa vende me kubze, e në disa me asfalt, prandaj duhet të bëhet demolimi i pllakave (kubzeve) nga betoni dhe materialeve të tjera të ngurta, si dhe vendosja e një shtrese nga tampon me  $M_v > 70 \text{ MN/m}^2$  prej gurit të thyer gëlqeror, me fraksion: 0-30mm, me trashësi  $t = 10 \text{ cm}$ , si bazë për vendosjen e shtresës së re nga asfalti me  $t = 5,0 \text{ cm}$  në trotuare. Në rrugë janë gjithsej 6 puseta dhe 6 grila, që duke e pasur parasysh mirëmbajtjen e kanalizimit dhe në disa vende vërehet se grilat janë të bllokuara, atëherë është mirë që të bëhet pastrimi i të gjitha pusetave dhe ujëmbledhësve, si dhe vendosja e kapakëve dhe grilave të reja aty ku janë të dëmtuara, sipas nevojës. Sinjalizimi horizontal është i dëmtuar, e në disa vende mungon, andaj duhet të parashihet edhe vendosja e sinjalizimit të ri horizontal.



## Rruga “Mustafë Hoxha”

**L=450 m** me **b=4.0 m**, me trotuare në të dy anët e rrugës, të cilët shkojnë deri në **1.0 m**. Rruga është me shtresë kaluese nga asfalti, në një pjesë prej 30 m<sup>2</sup> rruga është e dëmtuar, andaj duhet të bëhet demolimi i asfaltit. Në pikat ku kemi deformime të asfaltit duhet të bëhet gërmimi i dheut të kategorisë: III, IV dhe V me makinë dhe dorë, në raport (70 me 30%) pas heqjes së asfaltit në pikat ku kemi dëmtim të bazës së asfaltit, në thellësi -55cm, si dhe kompaktimi pas rrafshimit me modul të ngjeshjes  $M_v > 30 \text{ MN/m}^3$ , duhet të parashihet edhe largimi i dheut dhe asfaltit deri në deponi, si dhe vendosja dhe ngjeshja e tamponit  $M_v > 90 \text{ MN/m}^2$  prej gurit të thyer gëlqeror, me fraksion: 0-63mm, me trashësi  $t=40\text{cm}$ , si bazë për vendosjen e trupit të rrugës në pikat ku kemi dëmtime të konstruksionit të rrugës, si dhe punimi i shtresës së binderagregatit 0-31CS, me trashësi  $t=10,0\text{cm}$ , si dhe spërkatjen me emulsion në hapësirat ku kemi larguar asfaltin për përforcim të bazës. Duhet të bëhet gërryerja e shtresës finale ekzistuese të asfaltit në tërë hapësirën e rrugës dhe vendosja e një shtresës përfundimtare nga asfalt betonit AB16S, me trashësi  $t=5,0\text{cm}$ , duke përfshirë pastrimin, larjen dhe spërkatjen me emulsion në tërë hapësirën e rrugës para shtrimit të asfalt betonit.

Trotuaret në disa vende janë nga betoni, në disa vende me kubze, e në disa me asfalt, andaj duhet të bëhet demolimi i pllakave (kubzeve) nga betoni dhe materialeve tjera të ngurta, si dhe vendosja e një shtrese nga tampon me  $M_v > 70 \text{ MN/m}^2$  prej gurit të thyer gëlqeror, me fraksion: 0-30mm, me trashësi  $t=10\text{cm}$ , si bazë për vendosjen e shtresës së re nga asfalti me  $t=5,0\text{cm}$  në trotuare. Në rrugë janë gjithsej 25 puseta dhe 15 grila, që duke e pasur parasysh mirëmbajtjen e kanalizimit dhe në disa vende vërehet se grilat janë të bllokuara, atëherë është mirë që të bëhet pastrimi i të gjitha pusetave dhe ujëmbledhësve, si dhe vendosja e kapakëve dhe grilave të rejave aty ku janë të dëmtuara, sipas nevojës. Sinjalizimi horizontal është i dëmtuar, e në disa vende mungon andaj duhet të parashihet edhe vendosja e sinjalizimit të ri horizontal. Në lidhje të rrugës “Mustafë Hoxha” dhe “Bajram Kelmendi” ka nevojë për muri mbrojtës, me gjatësi prej  $L=20 \text{ m}$  dhe  $H= 2.0 \text{ m}$ .



### Rruga “Bajram Kelmendi” (nga rruga “Ernest Koliqi” deri te “1 Tetori”)

**L=720 m** me **b=6.0 m**, me trotuare në të dy anët e rrugës, të cilët shkojnë nga **1.0 m** në **2.0 m**. Rruga është me shtresë kaluese nga asfalti, në një pjesë prej 20 m<sup>2</sup> rruga është e dëmtuar, andaj duhet të bëhet demolimi i asfaltit. Në pikat ku kemi deformime të asfaltit duhet të bëhet gërmimi i dheut të kategorisë: III, IV dhe V, me makinë dhe dorë, në raport (70 me 30%) pas heqjes së asfaltit në pikat ku kemi demtim të bazës së asfaltit në thellsi - 55cm, si dhe kompaktimi pas rrafshimit me modul të ngjeshjes  $M_v > 30 \text{ MN/m}^3$ . Duhet të parashihet edhe largimi i dheut dhe asfaltit deri në deponi, si dhe vendosja dhe ngjeshja e tamponit  $M_v > 90 \text{ MN/m}^2$  prej gurit të thyer gëlqeror, me fraksion: 0-63mm, me trashësi  $t=40\text{cm}$ , si bazë për vendosjen e trupit të rrugës në pikat ku kemi dëmtime të konstruksionit të rrugës, si dhe punimi i shtresës së binderagregatit: 0-31CS, me trashësi  $t=10,0\text{cm}$ , si dhe spërkatjen me emulzion në hapësirat ku kemi larguar asfaltin për përforsim të bazës. Duhet të bëhet gërryerja e shtresës finale ekzistuese të asfaltit në tërë hapësirën e rrugës dhe vendosja e një shtrese përfundimtare nga asfalt betoni AB16S, me trashësi  $t=5,0\text{cm}$ , duke përfshirë pastrimin, larjen dhe spërkatjen me emulsion në tërë hapësirën e rrugës para shtrimit të asfalt betonit.

Trotuaret në disa vende janë nga betoni, në disa vende me kubza, e në disa me asfalt, prandaj duhet të bëhet demolimi i pllakave (kubzeve) nga betoni dhe materialeve tjera të ngurta, si dhe vendosja e një shtrese nga tampon me  $M_v > 70 \text{ MN/m}^2$  prej gurit të thyer gëlqeror, me fraksion: 0-30mm, me trashësi  $t=10\text{cm}$ , si bazë për vendosjen e shtresës së re nga asfalti me  $t=5,0\text{cm}$  në trotuare. Në rrugë janë gjithsej 20 puseta dhe 18 grila, që duke e pasur parasysh mirëmbajtjen e kanalizimit dhe në disa vende vërehet se grilat janë të bllokuara, atëherë është mirë që të bëhet pastrimi i të gjitha pusetave dhe ujëmbledhësve, si dhe vendosja e kapakëve dhe grilave të reja aty ku janë të dëmtuara, sipas nevojës. Sinjalizimi horizontal është i dëmtuar, e në disa vende mungon, andaj duhet të parashihet edhe vendosja e sinjalizimit të ri horizontal.




### Rruga “Xhelal Mitrovica”

**L=485m** me **b=4.0 m**, me trotuare në të dy anët e rrugës, të cilët shkojnë nga **1.0 m** në **2.0 m**. Rruga është me shtresë kaluese nga asfalti, në një pjesë prej 20 m<sup>2</sup> rruga është e dëmtuar, andaj duhet të bëhet demolimi i asfaltit. Në pikat ku kemi deformime të asfaltit duhet të bëhet gjermimi i dheut të kategorisë: III, IV dhe V, me makinë dhe dorë, në raport (70 me 30%). Pas heqjes së asfaltit në pikat ku kemi dëmtim të bazës së asfaltit në thellësi -55cm, si dhe kompaktimi pas rrafshimit me modul të ngjeshjes  $M_v > 30 \text{ Mn/m}^3$ , duhet të parashihet edhe largimi i dheut dhe asfaltit deri në deponi, si dhe vendosja dhe ngjeshja e tamponit  $M_v > 90 \text{ MN/m}^2$  prej gurit të thyer gëlqeror, me fraksion: 0-63mm, me trashësi  $t=40\text{cm}$ , si bazë për vendosjen e trupit të rrugës në pikat ku kemi dëmtime të konstruksionit të rrugës, si dhe punimi i shtresës së binderagregatit: 0-31CS, me trashësi  $t=10,0\text{cm}$ , si dhe spërkatjen me emulsion në hapësirat ku kemi larguar asfaltin për përforcim të bazës. Duhet të bëhet gjërryerja e shtresës finale ekzistuese të asfaltit në tërë hapësirën e rrugës dhe vendosja e një shtresës përfundimtare nga asfalt betonit AB16S, me trashësi  $t=5,0\text{cm}$ , duke përfshirë pastrimin, larjen dhe spërkatjen me emulsion në tërë hapësirën e rrugës para shtrimit të asfalt betonit.

Trotuaret në disa vende janë nga betoni, në disa vende me kubze, e në disa me asfalt, andaj duhet të bëhet demolimi i pllakave (kubzeve) nga betoni dhe materialeve tjera të ngurta, si dhe vendosja e një shtrese nga tampon me  $M_v > 70 \text{ MN/m}^2$  prej gurit të thyer gëlqeror, me fraksion: 0-30mm, me trashësi  $t=10\text{cm}$ , si bazë për vendosjen e shtresës së re nga asfalti me  $t=5,0\text{cm}$  në trotuare. Në rrugë janë gjithsej 22 puseta dhe 20 grila, që duke e pasur parasysh mirëmbajtjen e kanalizimit, në disa vende vërehet se grilat janë të bllokuara.



Atëherë, është mire që të bëhet pastrimi i të gjitha pusetave dhe ujëmbledhësve, si dhe vendosja e kapakëve dhe grilave të rejave aty ku janë të dëmtuara, sipas nevojës. Sinjalizimi horizontal është i dëmtuar, e në disa vende mungon, andaj duhet të parashihet edhe vendosja e sinjalizimit të ri horizontal.



### Rruga “Afrim Loxha”

**L=120 m** me **b=5.0 m**, me trotuare në të dy anët e rrugës, të cilët shkojnë nga **1.0 m** në **2.0 m**. Rruga është me shtresë kaluese nga asfalti. Duhet të bëhet gërryerja e shtresës finale ekzistuese të asfaltit në tërë hapësirën e rrugës dhe vendosja e një shtresës përfundimtare nga asfalt betonit AB16S, me trashësi  $t=5,0\text{cm}$ , duke përfshirë pastrimin, larjen dhe spërkatjen me emulsion në tërë hapësirën e rrugës para shtrimit të asfalt betonit.

Trotuaret në disa vende janë nga betoni, në disa vende me kubze, e në disa me asfalt, prandaj duhet të bëhet demolimi i pllakave (kubzeve) nga betoni dhe materialeve tjera të ngurta, si dhe vendosja e një shtrese nga tampon me  $M_v > 70\text{MN/m}^2$  prej gurit të thyer gëlqeror, me fraksion: 0-30mm, me trashësi  $t=10\text{cm}$ , si bazë për vendosjen e shtresës së re nga asfalti me  $t=5,0\text{cm}$  në trotuare. Në rrugë janë gjithsej 10 puseta dhe 6 grila, që duke pasur parasysh mirëmbajtjen e kanalizimit, në disa vende vërehet se grilat janë të bllokuara, atëherë është mirë që të bëhet pastrimi i të gjitha pusetave dhe ujëmbledhësve, si dhe vendosja e kapakëve dhe grilave të rejave aty ku janë të dëmtuara, sipas nevojës. Sinjalizimi horizontal është i dëmtuar, e në disa vende mungon, andaj duhet të parashihet edhe vendosja e sinjalizimit të ri horizontal.



Nga :

Besim Qelaj  
Zyhrie Pllana  
Krenar Xhaferi  
Amire Krasniqi  
Afërdita Sopi

## IDENTIFIKIMI I RRUGËVE PËR TRAJTIM APO RISANIM

### NË LAGJET "KODRA E TRIMAVE" DHE "ARBËRIA"

**Rrugë të reja..... 3705 m + 1070 m**  
**Rrugë me asfalt (risanim).....l= 850 m + 1020 m**  
**Rrugë me kubza (risanim).....l = 390 m + 250 m**  
**M. mbrojtëse..... 169 m (170 m<sup>3</sup> beton)**

Anëtarët e ekipit identifikues:

Ibrahim Gërvalla  
 Besim Qelaj  
 Irfete Zeneli  
 Behgjet Gashi  
 Afërdita Sopi

### LAGJJA "KODRA E TRIMAVE"

#### 1. Rruga "Bernard Llupi" (ritrajtim)

- rruga ..... l = 170m ; b = 5 m  
 - muri mbrojtës ..... l = 55 m ; h = 1 m

#### 2. Krahë të rrugës "Mon Balaj"

-krahu 1 ..... l=130 m ; b = 8 m  
 -krahu 1 ..... l=50 m ; b = 4 m

Totali = 180 m

#### 3. Krahë të rrugës "Shefki Desivojca"

- krahu 1, djathtas ..... l = 55 m ; b = 4m  
 - krahu 2, djathtas ..... l = 65 m ; b = 4m  
 - krahu 3, djathtas ("Hisen Arifi")..... l = 130m ; b = 4m  
 - krahu 4 majtas ..... l = 35m ; b = 4m

Gjithsej = 285 m

#### 4. Rruga "Selim Veselaj"

-rruga ..... l = 180 m ; b = 5 m  
 -muri mbrojtës ..... l = 90 m , h = 1.5m

**5. Rrugët afër rezervuarit të ujit**

-krahë I i rrugës "Bedri Ahmeti" .....  $l = 280 \text{ m}; b = 5 \text{ m}$

\* Ekzistojnë si rrugë fizike, por nuk figurojnë si rrugë në gjeoportale

**6. Krah i rrugës "27 Nëntori"**

-Muri mbrojtës .....  $l = 24 \text{ m}; h = 2 \text{ m}$

**7. Krah i rrugës "Asllan Pireva"**

-rruga "Dasho Shkreli".....  $l = 300 \text{ m}; b = 4 \text{ m}$

\* ekziston si rrugë fizike, ndërsa në gjeoportale figuron si rrugë vetëm 140 m, duke filluar nga rruga „Asllan Pireva“.

**8. Rruga "Besim Levonja"**

-rr. kryesore.....  $l = 550 \text{ m}; b = 5 \text{ m}$

-krahë.....  $l = 100 \text{ m}; b = 4 \text{ m}$

Totali = 650 m

\* rruga fizike nuk përputhet (në pjesë të madhe) me rrugën që figuron në gjeoportale .

**9. Vazhdim i rrugës "Gjevat Begolli"**

- vazhdim i rrugës.....  $l = 670 \text{ m}; b = 5 \text{ m}$

- krahë 1, djathtas .....  $l = 250 \text{ m}; b = 4 \text{ m}$

- krahë 2, djathtas .....  $l = 45 \text{ m}; b = 4 \text{ m}$

- krahë 3, majtas .....  $l = 65 \text{ m}; b = 4 \text{ m}$

Totali = 1030 m

**10. Krahë i rrugës "Caraleva"- vazhdim i rrugës**

-rruga .....  $l = 60 \text{ m}; b = 4 \text{ m}$

**11. Krahët e rrugës "Vlora"**

-krahë 1 .....  $l = 60 \text{ m}; b = 4 \text{ m}$

-krahë 2 ("Lulzim Jashari").....  $l = 70 \text{ m}; b = 4 \text{ m}$  (vetëm kubza)

Totali = 130 m.

**10. Krahë i rrugës "Aziz Zhilivoda"**

-rruga .....  $l = 350 \text{ m}; b = 5 \text{ m}$

**11. Krahë i rr "Rrahim Beqiri" ( t err "Sheshi i Arbit")**

-rruga .....  $l = 260 \text{ m}; b = 5.0 \text{ m}$

**12.Rruga "Ismet Krasniqi" (risanim)**

Shtresa e re e asfaltit .....l = 850m , b =5.5 m

**13.Rruga "Eqrem Vlora" (risanim)**

-rruga ..... l= 220 m ;b= 5.5m

**Rekapitulim:****Rrugë të reja..... 3705 m****Rrugë me asfalt (risanim).....l= 850 m****Rrugë me kubza (risanim).....l = 390 m****M. mbrojtëse..... 169 m (170 m<sup>3</sup> beton)**

# LAGJJA "ARBËRIA"

## 1. Krah i rrugës "7 Shtatori"

- rruga „Skrapari” ..... l = 220m ; b = 5m

## 2. Krahë i rrugës "Dil Mramori"

- rruga "Sazani" ..... l = 260m ; b = 4m

\* ekziston si rrugë fizike, por nuk figuron si rrugë në gjeoportali.

## 3. Krahë të rrugës "Gjergj Balsha"

-krahët djathtas..... l=210 m ; b = 4m

-krahët majtas ..... l = 210m ; b = 4m

-krahu djathtas..... l = 380m ; b = 5m

Totali = 590 m

## 4. Rruga "Bekim Berisha"

- risanim me kubze .....l= 250m ;b=4m

## 5. Rruga "Ahmet Krasniqi"- shtresë asfalti

-risanim me asfalt (shtresë asfalti).....l= 520 m ; b=6m

## 8. Rruga "Plava" – shtresë asfalti


-risanim me asfalt (shtresë asfalti).....l = 500m ; b = 5.5 m

## Rekapitulim:

Rrugë të reja..... 1070 m

Rrugë me asfalt (risanim).....l= 1020 m

Rrugë me kubze (risanim).....l = 250 m



















## Identifikimi i lagjes “Kalabria”

### 1. Rruga “Fadil Hoxha”

Rruga ekzistuese e asfaltuar, ka nevojë për shtresë çarkulluese.


Gjatësia e rrugës  $L=415.00 \text{ m}^1$ , kurse gjerësia  $B=5.50 \text{ m}^1$ .

### 2. Rruga “Rexhep Krasniqi” dhe “Kasim Shala”

Rruga ekzistuese me kubze betoni, ka deformime të mëdha

Gjatësia e rrugës  $L_1=150.00 \text{ m}^1$ , kurse gjerësia  $B=6.50 \text{ m}^1$

$L_2=1270.00 \text{ m}^1$ , kurse gjerësia  $B=5.00 \text{ m}^1$



### 3. Ndërtimi i kanalizimit fekal te Banesat e Arabëve



### 4. Rrugët: “Agim Çela”, “Harun Aliu”, “Gafurr Loku” dhe “Asllan Pushka” duhet të sanohen nga KEDS.





## 6. Ndërtimi i kanalizimit fekal te Shkolla Bujqesore





Komuna e Prishtinës  
RAPORTI MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave
Sektori	Menaxhimi i kontratave për ndërtim të lartë
Periudha raportuese	Janar, 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Ferit Fazliu, shef i Sektorit

• **PËRMBLEDHJE**

Ky sektor në bazë të detyrave programore, kryesisht është marrë me përpunimin e lëndëve me problematikë të ndërtimit, hartimin e detyrave projektuese, mbikëqyrjen e projekteve, mbikëqyrjen e objekteve, hapjen dhe vlerësimin e tenderëve , pjesëmarrje në komisionet e caktuara nga Kryetari i Komunës dhe drejtori i Drejtorisë për fushën e ndërtimit dhe veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me këtë sektor.

• **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2019**

Për vitin 2019 janë planifikuar këto aktivitete të Sektorit për menaxhimin e kontratave të ndërtimit të lartë, e që janë dhe pjesë e aktiviteteve të Drejtorisë:

- Pjesëmarrje në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve.
- Mbikëqyrje e kontratave të ndërtimit të lartë të projekteve që investon Komuna ose investuesve të tjerë për nevoja të Komunës:
  - Rritja e efikasitetit dhe kualitetit në realizimin e kontratave,
  - Realizimi i planit dinamik dhe ruajtja e buxhetit;
- Përgatitja e raportit mujor dhe vjetor;
- Këshillimi i Drejtorit dhe sektorëve tjerë për çështjet e ndërtimit, si dhe
- Aktivitete të paplanifikuara me kërkesë të organeve të Komunës.

## • AKTIVITETET E REALIZUARA

Gjatë këtij muaji janë ekzekutuar këto aktivitete:

- Zgjedhja e lëndëve sipas kërkesave të palëve:
  - të pranuar gjatë këtij muaji - 8 lëndë.
  - të zgjidhura 8 lëndë;
- Vlerësim të kontratave – 0.

Gjithsej vlera e kontratave që janë në menaxhim të këtij sektori është 4,898,391.14 €  
Nga këto:

- 6 projekte janë të ndërprera, nga këto:
  - 3 projektet nuk kanë filluar fare, për shkak të pronës,
  - 1 kontratë “Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore: Shtëpi banimi - Sali Savqi dhe Shkolla e parë shqipe”. Shkolla e parë shqipe është përfunduar, ndërsa objekti-shtëpia e Sali Savqit, nuk është punuar për shkak të mungesës në kontratë të pozicioneve për stabilitet.
  - 2 kontrata janë ndërprerë përkohësisht punimet, si rezultat i lidhjes së tyre me aktivitete të tjera.

Vlera e këtyre kontratave është: 3,004,938.04 €, me mjete të papaguara në vlerë prej : 2,969,555.97 € .

- 10 kontrata-projekte vazhdojnë në vitin 2019 ( nga vitet paraprake ), nga këto:
  - 6 janë kontrata kornizë, që janë afër përfundimit, por nuk janë përfunduar komplet 1,260,543.20 €, të shpenzuara deri tani janë: 975,261.94 € ( te këto kontrata lejohet +30% e vlerës së kontratës);
  - 5 kontrata janë kontraktuar rreth muajit të 10-të, e që vazhdojnë edhe në vitin 2019. Këto kontrata kanë vlerën prej: **299,402.85 €**, nga kjo vlerë janë shpenzuar : **131,248.37 €**.

Më poshtë po i listojmë kontratat - projektet sipas renditjes:

## KONTRATAT KORNIZË

1. Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive – kontratë kornizë 3-vjeçare	
Janë realizuar punime në: SHFMU në Sharban	
Vlera e projektit:	511,933.50 € për tri vite
Nr. i kontratës dhe data.	616 16 096 511, dt. 04.08.2016
Operatori ekonomik:	“NBT-ING” dhe NPN “Alfa-Ing” SHPK, Suharekë
Te paguara	<b>588,306.62 €</b>
Mbarëvajtja e punimeve:	
Nuk ka pasur aktivitet gjatë këtij muaji	

2. Rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e kulmeve të shkollave - kontrate 3-vjeçare	
Janë realizuar punime në: Është punuar në plafonin e sallës së edukatës fizike në shkollën “Pjetër Bogdani”	
Vlera e projektit:	233,454.00€ për tri vite
Nr. i kontratës dhe data.	616 16 052 521, dt. 06.07.2016
Operatori ekonomik:	“OLTI TRASING” Prishtine
Te paguara	243,593.72 €
Mbarëvajtja e punimeve:	Është punuar në plafonin e sallës së edukatës fizike në shkollën “Pjetër Bogdani”





### 3. "Mirëmbajtja e elektrikës në shkolla" - kontratë kornizë 3-vjeçare

Gjatë këtij muaji me kontratën " Mirëmbajtja e elektrikes në shkolla" është intervenuar në këto institucione:

1. Shkolla fillore "Zenel Hajdini"
2. Shkolla fillore "Pavarësia"
3. Kuzhina Qendrore

Nr. i kontratës dhe data:	nr. 616 16 099 211, dt. 02.09.2016.
Vlera e projektit:	63,228.30€ për tri vjet (21,076.10 € për një vit)
Investuesi:	Komuna e Prishtinës
Kontraktori:	Konzorciumi "Light and More" SHPK dhe NTSH "Monting", me lider "Light and More" SHPK nga Prishtina
Të paguara:	55,642.70 €
Fotot e ekzekutimit të punimeve	





4. Rikonstruktimi, gëlqerosja, mirëmbajtja e nyjave sanitare dhe rikonstruktimi i dyshemeve ne Institutinet Arsimore-LOT 2 - kontratë njëvojeçare

Janë realizuar punime në :  
**SHFMU "Asim Vokshi"**

Vlera e projektit:	48,000.00€ për nje vite
Nr. i kontratës dhe data.	616 16 022 521 dt. 20.07.2018
Operatori ekonomik:	"LINDI" - Istog
Të paguara	41,229.24 €
Mbarëvajtja e punimeve:	Aktivitete të shtuara në shume vend punishte

**FOTOT E EKZEKUTIMIT TË PUNIMEVE**





5. *Rikonstruktimi, gëlqerosja, mirëmbajtja e nyjave sanitare dhe rikonstruktimi i dyshemeve në Institucionet arsimore - LOT 3 – kontratë kornizë njëvojeçare*

Janë realizuar punime në :

**Ne mirëmbajtjen e nyjave sanitare në shumë IP, si dhe në shumë shkolla në qytet dhe fshatra**

Vlera e projektit:	69,659.90€ për një vite
Nr. i kontratës dhe data.	616 16 022 521 dt. 20.07.2018
Operatori ekonomik:	EURO KONSTRUKSION - Rahovec
Të paguara	31,850.90 €
Mbarëvajtja e punimeve:	Aktivitete të shtuara në shumë vendpunishte
<b>FOTOT E EKZEKUTIMIT TË PUNIMEVE</b>	





## KONTRATAT QE VAZHDOJNE NGA VITET PARAPRAKE DHE TË KËTIJ VITI




<i>6. Renovimi i zyrave në objektin e vjetër të Komunës</i>	
Punimet e realizuara deri me tani me këtë kontratë: Nuk ka pasur aktivitet gjatë këtij muaji.	
Vlera e projektit:	16,156.88 €
Nr. i kontratës dhe data.	616-18-1922-5-2-1, dt. 20.07.2018
Operatori ekonomik	NN "ZHVILLIMI"
Të paguara deri më tani:	
Fotot gjate ekzekutimit te punimeve	
	




7. "Ndertimi i konstruksioneve metalike për përvjetorin e arkitektit Rexhep Luci"	
Vlera e projektit:	3.870.40 €
Nr i kontratës dhe data.	16-18-6534-5-3-6
Investuesi	Komuna e Prishtinës
Plani dinamik	10 dite
Operatori ekonomik	"MBB Construction" Sh.P.K Caraleve, Prizren
Përshkrimi i punimeve sipas pozicioneve të realizuara	
Punimet janë përfunduar, pagesa nuk është kryer pasi që është lenë për vitin në vijim të sillen elementet për manifestim.	

<b>8. Rregullimi i oborreve të shkollave SHFMU “Elena Gjika” dhe SHFMU “Dardania”</b>	
Janë realizuar punime në : Rregullimi i oborreve te shkollave SHFMU “Elena Gjika” dhe SHFMU “Dardania”	
Vlera e projektit:	107,777.77€ për 90 dite
Nr. i kontratës dhe data.	616 18 105 521 dt. 03.10.2018
Operatori ekonomik:	ULPIANA - Prishtine
Të paguara	0.00 €
Mbarëvajtja e punimeve:	Aktivitete të shtuara në shumë vendpunishte
<b>FOTOT E EKZEKUTIMIT TË PUNIMEVE</b>	
Nuk është punuar në këtë muaj-punimet janë ndërprerë deri në pranverë, për shkak të kushteve atmosferike.	

<b>9. Ndërtimi i sallës së edukatës fizike të shkollës “Avni Rustemi” Mramuer</b>	
Janë realizuar punime në : Ndërtimi i sallës së edukatës fizike te shkollës “Avni Rustemi” Mramor	
Vlera e projektit:	167,257.80€ për 150 ditë
Nr. i kontratës dhe data	616 18 095 521, dt. 23.10.2018
Operatori ekonomik:	“A-CON” - Prishtine
Të paguara	0.00 €
Mbarëvajtja e punimeve:	Aktivitete të shtuara në shumë vendpunishte
<b>FOTOT E EKZEKUTIMIT TË PUNIMEVE</b>	
Nuk është punuar ne këtë muaj-punimet janë ndërprerë deri në pranverë, për shkak të kushteve atmosferike.	

10. Renovime dhe rindërtime të objekteve shëndetësore	
Vlera e projektit:	334.267,50€
Nr. i kontratës dhe data.	616-18-104-521, dt.1.11.2018
Investuesi	Kuvendi Komunal i Prishtinës
Plani dinamik	14,638.76 €
Operatori ekonomik	NTP "Ulpiana" dhe "Mati" SHPK
Përshkrimi i punimeve sipas pozicioneve të realizuara	
Foto gjatë ekzekutimit të punimeve	
QKMF	
	
	




Kuzhina Popullore





QMF5





### PROJEKTET E KONTRAKTUA DHE TË PAFILLUARA

11. Ndërtimi i shkollës fillore në lagjen „ Mati 1’’, vlera e projektit është 1,458,452.95€, nr. id. 61615061511, dt. 23.07.2015, punimet nuk kanë filluar, është në procedurë gjyqësorë për çështje pronësore.
12. Ndërtimi i sallës së edukatës fizike të shkollës “Shtjefën Gjeqovi”, vlera e projektit është : 238,564.24€, nr. id. 616 15 156 521, dt. 22.10.2015; punimet janë ndërprerë për shkak të pronës.
13. Ndërtimi i shkollës në lagjen “Kalabria”, vlera e projektit është 1,458,452.95 €; nr. id. 61615135511, dt. 30.10.2015; punimet nuk ka fillua për shkak te problemeve pronësore.

#### ✓ KËRKESAT E SEKTORIT

Kërkesa shumë të nevojshme:

- Sigurimi i pajisjeve për sigurinë e stafit në punishte ( helmata, këpuca, syze etj.);
- Plotësim të stafit **me elektro- inxhinierë, inxhinierë të makinerisë - termodinamikë dhe të Hidros;**
- Trajnime të stafit për menaxhim të projekteve-kontratave;

- Pjesëmarrje në panairët e ndërtimit, me qëllim të njoftimit me materialet e reja të ndërtimit;
- 1. Server për komplet drejtorinë, min. 10 Tera bajt .
- Sigurimi i pajisjeve mobile :
  - a. për matjen e lagështisë së betonit, drurit dhe llaqit,
  - b. kalueshmërinë e nxehtësisë-temperaturës,
  - c. kamerë termike,
  - d. Matjen e glykolit,
  - e. Matjen e temperaturës së ujit dhe
  - f. 5 metra laserike, me gjatësi matëse deri në 50 m.

**Drejtori :**

**Gëzim Mehmeti**

Janar, 2019  
Prishtinë